



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.99 dt.17.06.1997

**PER
MIRATIMIN E PLANIT TE SHPENZIMEVE NGA TE ARDHURAT
PER BASHKINE TIRANE PER MUAJIN MAJ 1997**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.17.06.1997, pasi mori në shqyrtim relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Financës “Për miratimin e planit provizor të shpenzimeve nga të ardhurat e Bashkisë për muajin maj 1997”, mbështetur në Dekretin e Presidentit të Republikës Nr.1786, dt.30.04.1997 “Për shpenzimet buxhetore për muajin maj 1997”, Ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, Ligjin Nr.7616, dt.30.09.1992 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligjin Nr.7582, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI

1. Të miratojë planin provizor të shpenzimeve për muajin maj 1997 për shumën 16.9 milion sipas zërave të detajuar në pasqyrën bashkalidhur këtij vendimi.
2. Diferenca në fund të katërmujorit për shumën 13.437 mijë lekë, të përfshihet në kuotata e shpenzimeve të planifikuara për muajin maj 1997, sipas vendimeve të marra nga Këshilli i Bashkisë Tiranë.
3. Diferenca e papërdorur që do të mbetet në fund të pesëmuajorit të përdoret për përballimin e shpenzimeve të domosdoshme deri në ardhjen e planit të buxhetit për vitin 1997 në bazë të vendimeve të Këshillit të Bashkisë Tiranë.
4. Me ardhjen e planit të buxhetit për vitin 1997, të zbatohet pika.5 e vendimit Nr.66, dt.15.05.1997 të Këshillit të Bashkisë Tiranë.
5. Ngarkohet Drejtoria e Financës në Bashkinë e Tiranës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI